

Mbi varfërinë

Amartiya Sen, çmim nobel në ekonomi, ka bërë një riformulim të konceptit të varfërisë që shkon përtej elementëve materialë, duke e parë atë si përmbushje e “aftësive”. Ai që jeton mbi pragun e varfërisë është dikush që ka një tërësi aftësish: aftësinë për të shkruar e lexuar, për të bërë një jetë të gjatë e të shëndetshme, për të lëvizur lirisht, dhe mundësinë për të marrë pjesë në jetën qytetare të komunitetit. Ky konceptim jo vetëm i jep kuptim material jetës së një individi por cek dhe dimensionin shpirtëror, jo material, të tij. Kështu, në stadin e zhvillimit ekonomik të vendit tonë është mbi këtë koncept që duhet të bazohet përcaktimi i çdo ndihme shtetërore ndaj shtresave në nevojë, qofshin ata pensionistë, invalidë, me aftësi të kufizuara, të papunë e me radhë. Por për qeveritë tona të tre dekadave, sa më nën pragun e varfërisë me qenë, aq më pak mundësi ka për të qenë aktivë politikisht.

Nisur nga kjo me erdhi ndërmend ideja e harruar se ekonomia duhet të jetë në shërbim të politikës, të interesave e vullnetit të popullit e jo e kundërta siç ka ndodhur e ndodh. Rusoi e Aristoteli kishin të drejtë në këtë pikë. Sepse shpesh harrohet se sa rëndësi ka dimensionin politik në jetën shoqërore, mundësia që secili të jetë aktiv politikisht, të mos jetë i kushtëzuar nga pamundësia ekonomike për të shprehur vullnetin e tij politik. Ne e dimë se shumë pensionistë, invalidë, njerëz me aftësi ndryshe, përpos vështirësive fizike, pavarasisht dëshirës nuk kanë sot mundësi ekonomike të marrin autobusin për të lëvizur lirisht në qytet (shëtitje, vizita, protesta, e me radhë) e as ta jetojnë qytetin e jetën social-politike. E vetmja utopi këtu është qeveria. •

Shkroi Alfred Bushi



ROSA LUXEMBURG STIFTUNG

Supported by Rosa Luxemburg Stiftung Southeast Europe with funds of the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ). This publication or parts of it can be used by others for free as long as they provide a proper reference to the original publication.

The content of the publication is the sole responsibility ICSE and does not necessarily reflect a position of RLS.

Introspektivë e një kamerieri sezonal

E enjte. Në darkë ndava rrobat që do merrja me vete. Deodorantë, furçë dhëmbësh, Autan u blenë të reja te hipermarketi i lagjes, lirë domosdo. I shkrova mesazh D për ca lekë borxh që më kishte, ndërkohë u takova me F që t’i ktheja një borxh. “Plak, më shpëtove jetën”, tha. Futi dorën në xhep, dhe midis dy kartpecetave shuk, një shufre filtrash e copa duhani, gjeti një rab të mbështjellë keq me celofan e ma ngjeshi në pëllëmbë si uratë e gjyshes. Të premten u nisa. Ora 12:00, përshëndetem me shoferin e autobusit dhe e pyes se ku të ulem. Më sheh me përtesë dhe zgjat dorën pas për të më treguar autobusin bosh. I bëj llogaritë shpejt. Në fund do jetë vapë, situatë depresive. Në mes ka nëna me fëmijë, qese me patatina dhe pure bebesh. Ulem te dera e pasme, edhe pse do doja të shmangia kontaktin pamor me çdo pasagjer të ri që do begenisë prej kësaj dere. Rrugë e gjatë. Përbri kam një spanjoll i cili gjithë kohës bisedon me një vajzë në rreshtin paralel. Muzika po fillon të më lodhë dhe për inerci e pyes spanjollin se ku po shkojnë. Nuk më intereson me të vërtetë. “Der... Dermi”, thotë. “Dhërmi, expensive” i them, dhe fill pendohem që hapa rrugën për të bërë një analizë socio-ekonomike me turistin që nuk i intereson aspak të dëgjojë skicën time për Shqipërinë varrezë. “Dermi, bjutiful!” vazhdon turisti. Vazhdoj të dëgjoj muzikë në kufje.

Zbres me turistët spanjollë dhe bashkë fillojmë ecjen drejt bregdetit. Nuk shkëmbejmë fjalë, përveç disa dreksioneve për zona shërbimi e plazhe të virgjëra, të cilat çdo vit zhvirgjërohen prej mijëra trupave të mahnitur me karta krediti në kasën e telefonit dhe aparate analoge të varur në qafë. Rrugës ndaloj te plakuri Neço. Marr një paketë duhani, dhe përshëndetem me të. Kard or kesh?, më pyet. Kesh, Neço, kjo është monedha e të varfërve. Nuk i kujtohet aspak që kam qenë këtu edhe një vit më parë, e unë nuk kam asnjë pretendim ndryshe. Arrij në lokal me një mallëngjim të çuditshëm. Kryekamerieri A po lan pistën me zorë ujë, më përgatit një kafe dhe më përditëson me afrimet e reja në staf. E vjehrra e pronarit paska ndërruar jetë në dimër. Jo fort lajm i hidhur, kur kujton skërmitjen e saj pas qafës tonë për

të na parë përherë të zënë me diçka. Plakë e ligë. Shkoj në dhomë. Ende nuk kundërmon erë këmbë dhe deodoranti AXE. Tre krevate janë bosh. Ulem te ai që është afër derës, nuhas çarçafët dhe sistemoj rrobat në fund të krevatit. Kundërmon erë prej vitit të shkuar, mendoj me veten. Apo më duket mua. Vij edhe njëherë vërdallë në katin e dytë, aty ku ndodhen dhomat tona, dhe shoh mbi një prej krevateve objekte që duken femërore. Buzëqesh, të paktën diçka që të thyejë erën e bo*eve në këtë han sezonal.

Asnjë gjurmë prej pronarit. Do jetë në Angli duke kontrolluar shtëpitë e barit. Mirë deri këtu. Kur është aty, nuk ndihet shumë. Për çdo problem thotë “mos e rruani djema” dhe numëron para nëpër shkallë. Furnizime, riparime, teka kalamajsh, gjithçka del nga xhepi i tij. Nuk dëshiron të duket si pronar, prandaj e shoqja e menaxhon hapësirën me grusht të hekurt.

E shtunë, kemi punë. Dëgjoj detin të shumëllojshëm nëpër kolonat e restorantit, e teksa i afrohem tavolinës nr.6 kërkoj kontakt me dy klientë që po fotografojnë horizontin. “Përshëndetje!...” Porosisin. Vazhdon kështu për orë të tëra. Më pihet një cigare, mbështetem në banak. Shfletoj rrjetin në celular, asgjë me rëndësi. Sillem nëpër pistën e restorantit, si fletë që nuk di ku të bjerë. Jam i padukshëm, ndërroj tavlla duhani dhe mundohem të përfytyroj se bota është mpakur në hapësirën e këtij ish-kampi punëtorësh të kthyer në restorant. Nuk ia dal dot. Do parapëlqejja të kisha mbi shpinë vetëm përgjegjësitë e kamerierit, të qeverisja butë mbi këtë pistë të modeluar mbi skica Pinterest-i të një tratorie italiane. Por vjen një orë e ditës kur bien mbi mua gjithë pyetjet e brezit tim. Të gjitha shtyrë për në shtator. Në darkë marr një birrë dhe ulem së bashku me shokët e punës buzë detit. Tymosim, numërojmë bakshishet dhe baticat. Punëtori i parkimit na tregon se si ua parkon makinat vajzave dhe si nesër do i marrë Instagramin asaj me cincuecento-n e kaltër, ose të motrës. Mendoj për zgjaristin me fytyrën e kuqe, kuzhinierin e varur nga alkooli dhe sanitaren 50-vjeçare me duart e bërë harta-harta prej klorit. E bija punon në kuzhinë gjithashtu. Është e bukur, mban në kokë një shami të kadifenjtë dhe në darkë dëgjon muzikë në katin e dytë. Nuk pi duhan, e as bar për dreq.

E diel. Dhoma ka filluar të kundërmojë, është vështirë të të zërë gjumi prej vapës. Nëpër gjumë vërej këmbë të leshta që sillen nëpër dhomë, deodorantë dhe gjurmë uji nëpër dysheme. Aspiratori prej kuzhinës e deri në tavan duhet të kalojë disa metra nga dhomat, bombola e gazit është gjithashtu afër,

dhe çdo mëngjes e shoh si të kem humbur besimin komplet te teknika moderne. Zbres poshtë për kafën. Puna fillon në 12, dhe ndërkohë shpalos gjithë individualitetin tim gjysmëlakuriq përpara dy turistëve gjermane. Filloj të fjalosem me to teksa po zbresim për në plazh dhe për një moment e harroj se për pak do vesh uniformën, për një 12-orarësh të rrëmujshëm.

Është e pamundur të kesh kontakt kuptimplotë me dikë. Nuk kam kohë, dhe sytë më janë rrudhur si aguridhe prej pagjumësisë dhe substancave. Iu them vajzave se mbaroj punë në mesnatë. I takoj fill pas pune. Flasim për filma, skenën e post punk-ut dhe teksa ato numërojnë dhjetëra vendet në të cilat kanë udhëtuar prej kur ishin fëmijë, unë shtrihem në rrërë dhe tymos duhan. Njëres prej tyre i flihet, anohet në shezlllog dhe tjetra, Dorotea, lazdrohet në ballin e saj ngjitur me timin. Fillon të ndihet në faj për privilegjet e saj si evropiane e bardhë, më numëron punët vullnetare dhe diapazonin e drogërave sintetike që mund të gjesh në Berlin. Është errësirë, dhe e bëjmë ndanë shezllongut gjithçka nuk e thamë dot me gojë.

E hënë. Duroj pyetjet tejet vulgare të djemve dhe shikimet shpotitëse të sanitares M e cila ka sy gjithandej. Pohoj çdo gjë në mënyrë të moderuar dhe vazhdoj punën, duke simuluar interes kundrejt mbarëvajtjes së punës në atë restorant, ku nuk do mundesha kurrë të isha klient.

I falënderohem revolucionit gjerman dhe në mes të sezonit bëhem kryekamarier. Dallimin do e kuptojnë vetëm ata që punojnë nëpër hierarkitë e ndryshme të kamarierllëkut.

Shtator. Kthehem në qytet i nxirë. Më ka marrë malli për gjellën e mamasë dhe krevatin. Nuk kam kursyer dot shumë dhe pas dy ditësh çmallje filloj të kërkoj punë tjetër. Synoj ndonjë OJQ, betohem që nuk punoj më kamerier dhe tani bota bëhet më e madhe. Kam gjëra për t’u shqetësuar, më të mëdha se një sallë restoranti. Diplomë, pasione, energji.

Tetor. Nuk shkoj më larg se një sallë restoranti dy lagje më tej. •

Shkroi Enriko Peçuli.

Dogançja, gjuha e grevës

A e di se në fund të shekullit XVIII-XIX, punëtorët shqiptarë kishin shpikur disa gjuhë të koduara përmes së cilave ata komunikonin me njëri tjetrin në rast greve ose rreziku? Ata ishin muratorë, sharrxhinj, kallajxhinj dhe gdhendës të gurit që shëtisnin nga fshati në fshat në kërkim të punës. Por që shpesh emigronin edhe në vendet e tjera të Evropës. Për këtë arsye, muratorët emërmëdhenj të Përmetit, për ti bërë ballë vështirësive të rrugëve të emigrimit, shpikën zhargonin e Dogançes, e cila është një përzierje gjuhësore e shqipes, greqishtes dhe sllavishtes. Gurëgdhendësit e krahinës së Oparit dhe Kolonjës kishin gjuhën e tyre të koduar, Perishten. Lovidharçja, një nëndegë e Dogançes, ishte gjuha e koduar e sharrxhinjve. Kurse Delibecja gjuha e grevës e çirakëve dhe shegertëve të Shqipërisë së Mesme. Të tjera gjuhë të koduara të punëtorisë së vjetër duhen të kenë ekzistuar dhe ndoshta vazhdojnë të ekzistojnë si shprehje jetime e të pandërgjegjshme në proverba, këngë dhe dialekte, por vetëm Dogançja ka arritur të mbijetojë dhe janë të shumtë autorët që kanë shkruar për të. Më poshtë do të publikojmë disa shprehje të Dogançes*.

- Sherosim nga një shkume - pimë nga një kafe
- Sherosim nga një thanuqe - pimë nga një raki
- Vardie e bejshme dredh nomatin - puna e shumtë e ha njeriun
- Fillushi majkushit vardis mbathjaxhi - vëllai i babait punon këpucar
- Merze e mos rois se të vezhepsin nomatët - rri e mos fol se të dëgjojnë njerëzit
- Çitisi bragjon në rrabe - bëji mutin në kokë
- Ai nomat të ankis cacliqin - ai njeri të hap barkun
- Ja pëlcasim bero - kemi bajram
- Ja pëlcasim kukulet - kemi pashkë
- Bëj pazon me cimadhin dhe kapsi bezhot - bëj pazarin me të dhe merri lekët
- Zegosni gospon që tu zegosi ai - kërkoheni Zotin që tu kërkohë edhe ai
- Në zhërr ja pëlcasim kruspullim - në darkë kemi mbledhje
- Ngrecojnë kukulat e bëjshme - vijnë pushtetet e mëdha
- Më kol vardje sesa të mërzhesh në mojdë - më mirë në punë se në shtëpi
- Më kol pikosur se sa i zaganjepsur - më mirë i vdekur sesa i sëmurë

- Mos qezëro se të legosin nomatët - mos qesh se të shohin njerëzit
- Do dredhim persho me mbleko - do hamë përshesh me qumësht
- Fryjti tek mengresi allo - iku te personi tjetër
- Ku e rrucove penxhon - ku e preve dorën
- Kuspullo togza - mblidhi mendt
- Më vaptize me atë rokanë - më mërzhite me atë fjalë
- Ajo projke nuk ia pëllcet kokodhor - ajo grua nuk ka burrë
- Froi panxhen - jepi dorën

*Fjalori është marrë nga "Dogançja", libër i studiuesit Andrea Llukani të cilën mund ta gjeni edhe falas në version pdf në internet. •

Transformimi i një "Pikëllimi"

"Pikëllimi i netëve kosovare", e krijuar në 1989 është ndoshta e vetmja vepër e vlefshme e piktorit Edi Rama, i cili duke u bërë mëvonazi kryeministër i Shqipërisë, pamë sesi pikëpamja e tij artistike u bjerr në një batërdi betoni, blerje dhe kontroll të skenës artistike si dhe struktura të kushtueshme artistike disa milionëshe si "Kopështi i Edenit", sigurisht në kurriz të pronës dhe parave publike, qytetit dhe uljes së cilësisë së jetës për shumicën dërmuese të njerëzve të punës. •



Detaj nga piktura me titull "Pikëllimi i netëve kosovare".



VAPË, PABARAZI DHE PAGA TË ULËTA



Vera është stina ku pabarazitë klasore shfaqen më së shumti. Për më të pasurit e shoqërisë, ajo është periudha e shkuarjes më pushime, e shplodhjes, e shijeve, e gëzimit të asaj çfarë filozofë të ndryshëm e quajnë "lulja e jetës", e gëzimit të kohës së lirë. Por për më të shumtët, për klasën e njerëzve të punës, fizike por edhe mendore, të shtresës së ulët ashtu edhe të mesme, vera është stina kur lodhjes, strapacimit, të ardhurave të pamjaftueshme i shtohet edhe rritja e padurueshme e temperaturave dhe lëvizja nëpër një qytet ku autobusët nuk kanë ajër të kondicionuar, rrugët nuk kanë pemë, sheshet nuk kanë çesma. E megjithatë, përbrënda kësaj klase

njerëzish të punës ka kategori për të cilët vera është dyfish stërmundim: ndërtimtarët që punojnë nën diellin përvëlues në skela, punëtorët sezonalë në plazhe dhe deri tek fatorinot, bukëpjekëset/shitëset, pastruesit etj. Këta, të cilët nuk janë të paktë por qindra mijëra njerëz, janë të papërfillur në një botë ku pasojat e ndryshimeve drastike klimaterike nuk merren parasyshtë, si risku shëndetësor, riformatimi i kohës së punës, njohja e vështirësisë në paga etj. Përkundrazi, ata janë të flakur në një botë gjithnjë e më të nxehtë dhe gjithnjë e më të padrejtë. Por a ka ardhur koha të flasim për një kod të ri pune në përputhje me një botë që nuk është më si e djeshmia? •